



THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA
GIRARD ACADEMIC MUSIC PROGRAM

2136 RITNER STREET
PHILADELPHIA, PA 19145



Ms. Jovan A. Moore, *Principal*
Bianca Gillis, *Co-Principal*

Office: 215-400-8230
Fax: 215-400-8231

Të dashur prindër/kujdestarë,

Në vitin 2018, Akti 158 u nënshkrua si ligj nga guvernatori duke parashtruar kërkesat shtetërore për diplomim të cilat hyjnë në fuqi për nxënësit e klasave të vitit 2023 e më tutje. Që të marrin diplomën e shkollës së mesme, nxënësit duhet të përmbushin të gjitha kërkesat lokale të diplomimit në lidhje me kreditet dhe lëndët së bashku me kërkesat shtetërore të parashtruara në Aktin 158. Në Filadelfia këto kërkesa përfshijnë arritjen e 23.5 krediteve në total, në lëndët e duhura dhe duke përfunduar me sukses një projekt mësimor shërbimi.

Nxënësit duhet të plotësojnë gjithashtu njëren prej pesë rrugëve të Pensilvanisë të parashtruara më poshtë për të marrë diplomën dhe të demonstrojnë gatishmëri për karrierë dhe/ose kolegji. Më tepër informacion në lidhje me kërkesat shtetërore të Pensilvanisë për diplomim mund të gjendet te www.philasd.org/gradreq.

Administratorët, këshilltarët e shkollës dhe anëtarë të tjerë të ekipit të shkollës do të punojnë nga afër me secilin nxënës për të rishikuar dhe ndihmuar nxënësit që të vendosin se cila rrugë është më e mira për të plotësuar këtë kërkesë mbarështetërore për diplomim.

Ju lutemi mos hezitoni të telefononi shkollën dhe të caktoni një takim për të folur me këshilltarin e fëmijës tuaj në qoftë se keni pyetje për Aktin 158 dhe/ose rrugën e nxënësit tuaj për diplomim. Një korrespondencë e veçantë do t'u dërgohet prindërve të maturantëve, nxënësve të vitit të tretë dhe të dytë të tanishëm duke i informuar ata për statusin aktual të nxënësve në lidhje me kërkesën për diplomim dhe rrugët e rekomanduara.

Zyrat e Rajonit Shkollor për Angazhimin e Familjeve dhe Gatishmërinë për Shkollë të Lartë do të mbajnë sesionet e mëposhtme informative gjatë javëve të ardhshme për të ndihmuar nxënësit dhe familjet që të kuptojnë më mirë kërkesat shtetërore të Pensilvanisë. Do t'ju dërgohet regjistrimi për ngjarjet e mëposhtme

- Sesion informativ për familjen – 19 tetor 2022; 12:00 pasdite-1:00 pasdite ([LIDHJA](#))
- Sesion informativ për familjen – 19 tetor 2022; 5:30 pasdite-6:30 pasdite ([LIDHJA](#))
- Orët zyrtare për familjet – 20 tetor 2022; 10:00 paradite -11:00 paradite dhe 5:00 pasdite-6:00 pasdite ([LIDHJA](#))
- Orët zyrtare për familjet – 27 tetor 2022; 10:00 paradite -11:00 paradite dhe 5:00 pasdite-6:00 pasdite ([LIDHJA](#))
- Sesion informativ FACT (Akademia Familjare: Kurse dhe Trajnim) – 15 nëntor 2022; 10:00 paradite-11:00 paradite ([LIDHJA](#)) 6:00 pasdite-7:00 pasdite ([LIDHJA](#))

AKTI 158 – Rrugët e diplomimit shtetëror

Nxënësit që do të diplomohen në vitin 2023 e më tutje duhet të plotësojnë njëren prej rrugëve alternative të mëposhtme për të plotësuar kërkesat e shtetit për diplomim:

Rruga bazë e aftësisë 1: Rezultat i aftë ose i avancuar në të tre provimet bazë (algjebër I, letërsi dhe biologji)

Rruga bazë e përbërë 2: Të marrë një rezultat të përbërë të kënaqshëm (4452) në provimet bazë për algjebër I, letërsi dhe biologji (ndërsa arrin të paktën një rezultat si i aftë/i avancuar dhe asnjë rezultat poshtë bazës në dy të tjerat)



THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA
GIRARD ACADEMIC MUSIC PROGRAM

2136 RITNER STREET
PHILADELPHIA, PA 19145



Ms. Jovan A. Moore, *Principal*
Bianca Gillis, *Co-Principal*

Office: 215-400-8230
Fax: 215-400-8231

Rruga e karrierës dhe arsimit teknik 3: Përqendruetit CTE (Arsimi Teknik dhe për Karrierë) (nxënësit që kanë plotësuar 50% a më shumë të programit të regjistruar CTE): përfundim me sukses i kërkesave të caktuara lokalisht me bazë klase për fushat me përmbajtje akademike të lidhura me secilin provim bazë (d.m.th. të kalojë klasat mësimore përfundimtare në algjebër I, biologji dhe anglisht 2) dhe **NJË** nga të mëposhtmet:

- Marrja e një çertifikate kompetence me bazë industrie
- Demonstrimi i një gjase të madhe për sukses në një vlerësim kompetence me bazë industrie
- Gatishmëri për angazhim të vazhdueshëm në programin e studimit të përqendruetit CTE

Rruga e vlerësimit alternativ 4: Plotësimi me sukses i kërkesave të caktuara lokalisht me bazë klase për fushat me përmbajtje akademike të lidhura me çdo provim bazë (d.m.th. kalimi i klasave përfundimtare në algjebër I, biologji dhe anglisht 2) **DHE** një nga të mëposhtmet:

- Arritja e një rezultati të caktuar në një vlerësim alternativ të aprovuar: SAT (1010), PSAT (970), ACT (21), ASVAB (31)
- Nivel të artë në vlerësimin ACT WorkKeys
- Arritja e rezultatit 3 ose më lart në një provim të programit të vendosjes së avancuar në një fushë me përmbajtje akademike të lidhur me çdo provim bazë në të cilin nxënësi nuk mori të paktën një rezultat të aftë
- Arritja e rezultatit 4 ose më lart në një provim baçelor ndërkombëtar në një fushë me përmbajtje akademike të lidhur me çdo provim bazë në të cilin nxënësi nuk mori të paktën një rezultat të aftë
- Përfundimi me sukses i një kursi me regjistrim paralel (klasë në kolegji me regjistrim të dyfishtë) në një fushë me përmbajtje akademike të lidhur me çdo provim bazë në të cilin nxënësi nuk mori të paktën një rezultat të aftë
- Përfundimi me sukses i një programi paraprak të stazhit të punës
- Pranimi në një institucion të studimeve të larta të akredituar jo fitimprurës 4 vjeçar dhe evidencë e aftësisë për t'u regjistruar në kurse të nivelit universitar

Rruga në bazë provash 5: Plotësimi me sukses i kërkesave të caktuara lokalisht me bazë klase për fushat me përmbajtje akademike të lidhura me çdo provim bazë (d.m.th. kalimi i klasave përfundimtare në algjebër I, biologji dhe anglisht 2) **DHE** demonstrim i tre (3) evidencave në përputhje me synimet dhe planet e karrierës të nxënësit duke përfshirë:

- **NJË** ose më shumë nga të mëposhtmet:
 - Arritja e nivelit të argjendit në vlerësimin ACT WorkKeys
 - Arritja e rezultatit 3 ose më lart në çfarëdolloj provimi të programit të vendosjes së avancuar
 - Arritja e rezultatit 3 ose më lart në çfarëdolloj provimi baçelor ndërkombëtar
 - Pranimi në një institucion të arsimit të lartë (IHE) jo 4 vjeçar për kurse të nivelit universitar
 - Marrja e një kredenciali të njohur nga industria
 - Përfundimi me sukses i çfarëdolloj regjistrimi paralel ose kursi pas shkollës së mesme
- Dhe **jo më shumë se DY** evidenca shtesë nga të mëposhtmet:
 - Përfundimi i mjaftueshëm i një projekti mësimor shërbimi
 - Arritja e një rezultati të aftë ose të avancuar në çfarëdolloj provimi bazë
 - Letër që garanton punësim me orë të plota ose regjistrim në ushtri
 - Përfundimi me sukses i një stazhi pune ose programi arsimor kooperativ



THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA
GIRARD ACADEMIC MUSIC PROGRAM
2136 RITNER STREET
PHILADELPHIA, PA 19145



Ms. Jovan A. Moore, *Principal*
Bianca Gillis, *Co-Principal*

Office: 215-400-8230
Fax: 215-400-8231

- Përbushje e mjaftueshme e kërkesave akademike të Divizionit II të NCAA-së (Shoqata Kombëtare Atletike e Kolegjeve)

Ne jemi të përkushtuar që të sigurojmë një nivel të lartë mbështetjeje për nxënësit dhe familjet në përgatitje për diplomimin e nxënësve.

Sinqerisht,

Jovan A. Moore
Drejtori i shkollës